


UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI"
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI"
Prizren



Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë, Tel +383 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Nr. i ref. 01- _____

Prizren, me: ____/____/____

Bazuar në dispozitat e nenit 16 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 , si dhe vendimin e Këshillit Drejtues të Universitetit „Ukshin Hoti“ në Prizren nr. 01-465 të datës 24.07.2023 , shpall:

KONKURS
PËR PUNË PRAKTIKE ME PAGESË PËR STUDENTËT E
UNIVERSITETIT "UKSHIN HOTI"

Ftohen studentët e vitit të fundit dhe ata të diplomuar në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren që të aplikojnë për punë praktike në administratën e Universitetit në pozitat përkatëse si më poshtë:

- Katër praktikantë në zyrat e dekanëve të njësive akademike;
- Dy praktikantë në zyrën për shërbime studentore;
- Dy praktikantë në Zyrën e Teknologjisë së Informacionit;
- Një praktikant në Zyrën për Buxhet dhe Financa;

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë studentët e vitit të fundit të studimeve dhe të diplomuarit në Universitetin "Ukshin Hoti".

Të gjitha profilet e studimeve në Universitet mund të aplikojnë për këto pozita, përjashtuar praktikantët për Zyrën e Teknologjisë së Informacionit dhe Zyrën për Buxhet dhe Financa që duhet të jenë nga fakultetet përkatëse sipas profilit.

Kriteret për përzgjedhjen e studentëve për punë praktike:

Vlerësimi i studentëve për këto pozita bëhet sipas sistemit të pikëve. Numri maksimal i pikëve është 100. Deri në 40 % të pikëve kandidati i mbledh nga nota mesatare, deri në 40% nga intervista me gojë dhe deri në 20% nga vlerësimi i CV dhe letrës motivuese.

Kohëzgjatja e punës praktike është tre (3) muaj.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim dhe mënyra e aplikimit

Kandidatët me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë:

1. Letrën motivuese dhe CV-në.
2. Kopjen e diplomës- diplomuarit.
3. Certifikatën e notave- studentët e vitit të fundit.
3. Kopjen e letërnjoftimit
4. Certifikatën penale

- Data për aplikim është nga 22.12.2023 deri më 31.12.2023, në ora 16:00.
- Për kohën e intervistës studentët do të njoftohen me kohë përmes emailit.
- Shpallja e listës me kandidatët e përzgjedhur nga komisioni ad hoc do të bëhet me datën 10.01.2024.
- Studentët e përzgjedhur për punë praktike, do të nënshkruajnë kontratën e angazhimit me Universitetin.
- Dokumentet duhet të dorëzohen në formatin elektronik pdf në e-mail adresën: karriera.alumni@uni-prizren.com
- Studentët do të jenë të angazhuar me orar të plotë sipas rregullores 01-638 (08:00-16:00)

Kandidatët që nuk pranohen kanë të drejtë ankese në afat prej 3 ditësh në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave që funksionon në kuadër të Universitetit.

Inkurajohen që të aplikojnë të gjithë studentët e Universitetit pa kurrfarë dallimi, respektivisht të gjithë ata të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Praktikantët në përfundim të punës praktike do të pajisen nga Universiteti “Ukshin Hoti” me: Referencë dhe Certifikatë.